



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 27 nëntor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar lidhur me Kontaktimin e
Dëshmitarëve pas Dhënies së Dëshmisë**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(2), 23(1), dhe 40(2) dhe 40(6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 80(1) dhe 116(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin ("Vendimi mbi Kontaktet")¹ në të cilin përcaktoi "Kornizën për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar" ("Protokolli për Kontakte").²
2. Më 27 dhjetor 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelet e ekipeve të Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Kontaktet dhe konfirmoi Protokollin për Kontakte ("Vendimi i Apelit").³
3. Më 4 shtator 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi kërkesë në lidhje me kontaktimin e dëshmitarëve pas dhënies së dëshmisë ("Kërkesa").⁴
4. Më 14 shtator 2023, ekipet e Mbrojtjes të Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit"), Rexhep Selimit ("Mbrojtja e Selimit") dhe Jakup Krasniqit ("Mbrojtja e Krasniqit") (së bashku "Mbrojtja") u përgjigjën ndaj Kërkesës ("Përgjigjja e Mbrojtjes").⁵

¹ F00854, Gjykatësi Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar*, 24 qershor 2022.

² Vendimi mbi Kontaktet, para. 212.

³ IA024/F00019, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar*, 27 dhjetor 2022.

⁴ F01765, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë në lidhje me kontaktimin e Dëshmitarëve pas Dhënies së Dëshmisë*, 4 shtator 2023.

⁵ F01790, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit ndaj Kërkesës së Prokurorisë në lidhje me kontaktimin e Dëshmitarëve pas Dhënies së Dëshmisë (F01765)*, 14 shtator 2023.

5. Gjithashtu, më 14 shtator 2023, Mbrojtësi i Viktimave u përgjigj ndaj Kërkesës (“Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave”).⁶

6. Më 22 shtator 2023, ZPS-ja u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes dhe Përgjigjes së Mbrojtësit të Viktimave (“Kundërpërgjigjja”).⁷

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses “të urdhërojë që Protokollit për Kontakte të zbatohet për të gjitha kontaktet me” dëshmitarë të palës kundërshtare ose pjesëmarrës kundërshtarë (“dëshmitarët e palës kundërshtare”), në përputhje me protokolle të ngjashme të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”).⁸ ZPS-ja parashtron se, edhe pse zbatimi i Protokollit për Kontakte aktualisht përdoret vetëm për kontakte para dhënies së dëshmisë, zgjerimi i zbatimit të Protokollit për Kontakte për të gjitha kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare është i domosdoshëm për: (i) mbrojtjen e dëshmitarëve; (ii) respektimin e pritshmërisë së arsyeshme për privatësi; (iii) garantimin e mbajtjes së pëlqimit të dëshmitarit dhe për t’i mundësuar dëshmitarit kërkimin e ndihmës në lidhje me kontaktimet; (iv) krijimin e një regjistri transparent dhe të qasshëm të kontaktimeve pas dhënies së dëshmisë; (v) ndihmë për vlerësimin e të gjitha pretendimeve për ndërhyrje; dhe (vi) konkretizimin e detyrimeve të palëve dhe pjesëmarrësve përmes një procedure të parashikueshme dhe përputhëse që vlen për të gjitha kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare.⁹ ZPS-

⁶ F01791, Mbrojtësi i Viktimave, *Përgjigje e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Kërkesës së Prokurorisë në lidhje me Kontaktimin e Dëshmitarëve pas Dhënies së Dëshmisë*, 14 shtator 2023.

⁷ F01812, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Saj për Kontaktimin e Dëshmitarëve pas Dhënies së Dëshmisë*, 22 shtator 2023.

⁸ Kërkesa, para. 1, 6 duke iu referuar ICC, [Chambers Practice Manual](#), Annex: Protocol on the Handling of Confidential Information during Investigations and Contact Between a Party or Participant and Witnesses of the Opposing Party or of a Participant, July 2023, pp. 37-47.

⁹ Kërkesa, para. 1, 3 i referohet Vendimit mbi Kontaktet, para. 116-125.

ja gjithashtu argumenton se, pas dëshmisë, dëshmitarët kanë të drejtë për përmbyllje në njëfarë mase.¹⁰

8. Mbrojtësi i Viktimave mbështet Kërkesën dhe pohon se nuk ka dyshim se viktimat pjesëmarrëse në proces (“VPP”) kanë pësuar pasoja drejtpërdrejt ose tërthorazi nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (“UÇK”).¹¹ Mbrojtësi i Viktimave argumenton se mund të imagjinohet lehtë efekti i pritshëm ndaj VPP-ve nëse kontaktohen në emër të figurave të larta të UÇK-së siç janë të akuzuarit.¹² Mbrojtësi i Viktimave parashtron se qëllimi dhe synimi i Protokollit për Kontakte është që të trajtojë këto shqetësime, që nuk pushojnë pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, dhe të parandalojë shkaktimin e sërishëm të traumave për dëshmitarët dhe viktimat.¹³ Mbrojtësi i Viktimave argumenton se Protokollit për Kontakte duhet të ndryshohet sepse Mbrojtja tani ka ngritur mundësinë që të kontaktojë dëshmitarët pas dhënies së dëshmisë.¹⁴

9. Mbrojtja e kundërshton Kërkesën pjesërisht, duke sugjeruar që Trupi Gjykes mund të zgjerojë zbatimin e Protokollit për “dëshmitarë të zgjedhur me masa mbrojtëse”.¹⁵ Mbrojtja e kundërshton Kërkesën në lidhje me dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi pa masa mbrojtëse, duke argumentuar se Protokollit për Kontakte shprehimisht parasheh që vlen vetëm për kontakte me dëshmitarë “para dhënies së dëshmisë”.¹⁶ Mbrojtja parashtron se dëshmitarët nuk janë pronë e asnjërës palë,¹⁷ dhe se Protokollit për Kontakte i jep përparësi interesit të ZPS-së për paraqitjen e dëshmitarëve të saj pa ndonjë ndikim nga marrja në pyetje nga Mbrojtja për qëllime hetimore.¹⁸ Mbrojtja argumenton më tej se, kur një dëshmitar i ZPS-së dëshmon në gjykim, baraspesha e interesave duhet të anojë në dobi të së drejtës së të akuzuarve të

¹⁰ Kërkesa, para. 5.

¹¹ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 8, 14.

¹² Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8.

¹³ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 9-10.

¹⁴ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 11.

¹⁵ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 23, 28.

¹⁶ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 6, 16, 28.

¹⁷ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 1.

¹⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 2.

bëjnë hetime.¹⁹ Së fundi, Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se ka pasur ndryshim materiale të rrethanave që nga Vendimi i Apelit për të përligjur zgjerimin e propozuar të Protokollit për Kontakte.²⁰

10. ZPS-ja kundërpërgjigjet se zgjerimi i zbatimit të Protokollit për Kontakte vetëm për dëshmitarë të mbrojtur do t'i cenonte qëllimet e Protokollit për Kontakte dhe zgjerimin që kërkohet, konkretisht, mbrojtjen, privatësinë, ruajtjen e provave dhe shpejtësinë e procesit.²¹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Protokollit për Kontakte, i cili u konfirmua në Vendimin e Apelit,²² parasheh:

II. Kontaktet midis një pale ose pjesëmarrësi dhe dëshmitarëve të palës ose pjesëmarrësit kundërshtar

- a. Përveç sipas kushteve të përcaktuara këtu, palët dhe pjesëmarrësit nuk kontaktojnë apo intervistojnë dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit tjetër para dhënies së dëshmisë, në qoftë se palës ose pjesëmarrësit kundërshtar i është njoftuar synimi për të thirrur dëshmitarin për të dhënë dëshmi ose për t'u mbështetur në deklaratën e tij.
- b. Në qoftë se dëshiron të intervistojë një dëshmitar të palës apo të pjesëmarrësit tjetër, pala ose pjesëmarrësi kundërshtar informon palën thirrëse dhe Njësinë e Administrimit të Gjykatës ("NJAGJ") dhe, në rastin e dëshmitarëve me status të dyfishtë, Mbrojtësin e Viktimave, të paktën dhjetë ditë para intervistës së synuar. Pala thirrëse verifikon me ndershmëri nëse dëshmitari jep pëlqimin të intervistohet nga pala kundërshtarë dhe gjithashtu informon dëshmitarin për mundësinë e pranisë në intervistë të përfaqësuesit të palës thirrëse, përfaqësuesit ligjor të dëshmitarit, Mbrojtësit të Viktimave në rastin e dëshmitarëve me status të dyfishtë, dhe/ose të përfaqësuesit të ZMMD-së. Në rrethana të veçanta, pasi të jetë këshilluar mjaftueshëm paraprakisht me Zyrën Administrative, pala ose pjesëmarrësi mund t'i drejtohet panelit që të kërkojë edhe praninë e një përfaqësuesi të Zyrës Administrative. Pala thirrëse e informon palën kundërshtarë nëse dëshmitari e jep pëlqimin. Gjithashtu, në rast se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të

¹⁹ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 3.

²⁰ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 12-13.

²¹ Kundërpërgjigjja, para. 2.

²² Vendimi i Apelit, para. 106.

tjera legjitime, pala thirrëse mund t'i kërkojë panelit ta lejojë të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit. Kur pala thirrëse parashtron para panelit apo i vë në dukje palës kundërshtare se do ta bëjë këtë, pala kundërshtare nuk do ta intervistojë dëshmitarin përpara se paneli të ketë lëshuar vendimin e vet. Procedura e kësaj pjese nuk zbatohet për intervistat e kryera nga ZPS-ja me dëshmitarë të palës kundërshtare lidhur me çështje të tjera gjyqësore, , përveçse kur ZPS-ja planifikon që në ato intervista të bëjë pyetje që janë relevante për akuzat në këtë çështje gjyqësore.

- c. Nëse pala ose pjesëmarrësi kontakton palën kundërshtare apo dëshmitarin pjesëmarrës në mënyrë të paqëllimshme, apo gjatë takimeve të kortezisë të organizuara prej ZMMD-së, ajo nuk bën asnjë diskutim mbi çështjen dhe nuk kërkon në asnjë rrethanë pëlqimin e dëshmitarit për t'u intervistuar drejtpërdrejt. Marrja e pëlqimit të dëshmitarit për t'u intervistuar mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurës së përcaktuar në nënparagrafin e mësipërm.
- d. Pala kundërshtare që kryen intervistën ("pala intervistuese"):
- i. siguron që intervista të kryhet në mënyrë efektive dhe të shpejtë;
 - ii. përgatit kopje të të gjitha dokumenteve që do t'i tregohen dëshmitarit në një gjuhë që dëshmitari e kupton, së bashku me përkthimin në anglishte që do t'i jepet palës thirrëse;
 - iii. nuk bisedon me dëshmitarin jashtë kuadrit të intervistës dhe të incizimit me video, në mënyrë që të gjitha deklaratat dhe çdo gjë që thuhet të evidentohen si duhet
 - iv. nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të konsiderohet kërcënues apo provokues; dhe
 - v. respekton urdhrat e lëshuar nga paneli.

[...]

- h. [...] Gjithashtu, sipas rastit, Zyra Administrative siguron që gjatë intervistës të jetë i pranishëm një sekretar i gjykatës apo një përfaqësues tjetër i caktuar i Zyrës Administrative, si dhe një përfaqësues për mbështetjen e dëshmitarëve në rastet kur ZMMD-ja e konsideron të nevojshme.
- i. Para fillimit të intervistës, pala intervistuese e informon dëshmitarin se:
- i. nuk e ka të detyrueshme pjesëmarrjen në intervistë dhe se mund të vendosë ta ndërpresë intervistën në çdo moment;

- ii. mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve, veçanërisht nëse mendohet se mund të jenë vetinkriminuese;
- iii. mund të kërkojë pushim në çdo moment; dhe
- iv. mund të kërkojë takim me një përfaqësues të ZMMD-së në çdo moment gjatë intervistës .

[...]

o. As incizimi i intervistës dhe as materialet e përdorura gjatë intervistës nuk bëhen pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore, përveç nëse paneli i pranon si prova *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, kur përmbushen kushtet për pranimin e tyre sipas Rregullores. Kur bëhet kërkesë për pranimin si provë të incizimit me video, pala intervistuese paraqet edhe transkriptin e intervistës.²³

IV. DISKUTIM

12. Trupi Gjykses nuk do të trajtojë kundërshtimet e përgjithësuara të Protokollit për Kontakte që ka ngritur Mbrojtja,²⁴ për të cilat është marrë vendim më herët.²⁵ Trupi Gjykses do ta përqendrojë vendimin te pyetja nëse detyrimet e përcaktuara në Protokollin për Kontakte duhet të zgjerohen që të mbulojnë periudhën pasi dëshmitari të ketë dhënë dëshmi, ose pas pranimit të deklaratës së dëshmitarit, kur ato pranohen sipas rregullës 153 ose 155.

13. Në thelb, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses të modifikojë, ose ndryshojë, Protokollin për Kontakte për të hequr kufizimin “para dhënies së dëshmisë”. Trupi Gjykses kujton se në paragrafin 71 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit përcaktohet:

Në lidhje me procedurën dhe garancitë mbrojtëse për kontaktet me dëshmitarët e palës apo pjesëmarrësit kundërshtar, palët dhe pjesëmarrësit i përmbahen [Vendimit të Apelit]. Nëse një palë ose pjesëmarrës gjykon se që nga [Vendimi i Apelit] ka pasur ndryshim material të rrethanave që ndikon në bazën mbi të

²³ Vendimi mbi Kontaktet, para. 212 (theksimet janë shtuar).

²⁴ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 1.

²⁵ F01467, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshim të Vendimit mbi Kontaktet në lidhje me W04147-ën* (“Vendimi për Ndryshimin e Vendimit mbi Kontaktet për W04147-ën”), 17 prill 2023, konfidencial, para. 26-27 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 31 tetor 2023, F01467/RED); F01719, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kontaktet me W04290-n* (“Vendimi në lidhje me Kontaktet me W04290-ën”), 16 gusht 2023, para. 19-20.

cilën është marrë vendimi, pala apo pjesëmarrësi mund të kërkojë mjetin e duhur juridik nga Trupi Gjykes.²⁶

14. Sipas mendimit të Trupit Gjykes, ZPS-ja nuk ka vërtetuar ndryshim material të rrethanave siç parashihet në paragrafin 71 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit. Nëse ZPS-ja argumenton se marrja në pyetje e dëshmitarëve në këtë çështje përbën ndryshim material që nga Vendimi i Apelit,²⁷ duke e përlligjur Kërkesën, Trupi Gjykes nuk pajtohet. Marrja në pyetje e dëshmitarëve është funksion thelbësor i gjykimit penal, dhe fakti që dëshmitarët kanë filluar të dëshmojnë që nga Vendimi i Apelit nuk mund të konsiderohet se është ndryshim material i rrethanave. Me fjalë të tjera, supozimi se dëshmitarët që janë objekt i Protokollit për Kontakte duhet të dëshmojnë, gjithsesi duhet të ketë qenë pjesë e konsideratave që çuan në pranimin e Protokollit në fjalë.

15. Megjithatë, kur miratoi Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, Trupi Gjykes theksoi se urdhri “mund të ndryshohet nga Trupi Gjykes, kur është e domosdoshme, gjatë ecures së gjykimit.”²⁸ Gjithashtu, në bazë të rregullës 116, Trupi Gjykes e ka detyrim, të vazhdueshëm, që “të marrë të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit”. Trupi Gjykes vë në dukje se Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit nuk merret me aspektin nëse pala që nuk e ka thirrur dëshmitarin mund të kontaktojë dëshmitarin e palës kundërshtare pas dhënies së dëshmisë, dhe gjykon se ndryshimi i Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, dhe rrjedhimisht i Protokollit për Kontakte, është i domosdoshëm për mundësimin e zhvillimit të procesit të drejtë dhe të shpejtë në pajtim me nenet 21, 23(1) dhe 40(2) dhe (6)(f) të Ligjit.

16. Trupi Gjykes gjithashtu kujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, kur la në fuqi Protokollin e Kontakteve, se Ligji nuk përcakton një listë shteruese e masave

²⁶ F01226/A01, Trupi Gjykes, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit* (Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit”), 25 janar 2023, para. 71.

²⁷ Kërkesa, poshtëshënimi 3.

²⁸ F01226, Trupi Gjykes, *Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, para. 10.

që duhet të merren për arritjen e qëllimeve, midis të tjerash, të mbrojtjes dhe privatësisë së viktimave dhe të dëshmitarëve.²⁹ Trupi Gjykses gjykon se rregulla 116 dhe nenet 21, 23(1) dhe 40(2) dhe (6)(f) të Ligjit ofrojnë bazë ligjore të përshtatshme për ndryshimin e Protokollit të Kontakteve në lidhje me kontaktet pas dhënies së dëshmisë.

17. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se disa dhoma gjyqësore të GJPN-së kanë miratuar protokolle për kontakte që zbatohen edhe pas dhënies së dëshmisë.³⁰ Gjithashtu, siç vë në dukje ZPS-ja,³¹ modeli standard i protokollit për kontakte që i është bashkëngjitur Udhëzuesit të Punës së Dhomave të GJPN-së të korrikut 2023, që rregullon kontaktet e palës thirrëse me dëshmitarët e palës jothirrëse, nuk e kufizon zbatimin e tij deri në momentin kur dëshmitari jep dëshmi në gjykim.³²

18. Gjithashtu, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën ("TPNR"), i kanë rregulluar kontaktet me dëshmitarë të palës kundërshtare pas dhënies së dëshmisë.³³

²⁹ Vendimi i Apelit, para. 26.

³⁰ *Shih për shembull*, ICC, *Prosecutor v. Bosco Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-412, Trial Chamber VI, [Decision on Adoption of a 'Protocol on the Handling of Confidential Information During Investigations and Contact Between a Party or Participant and Witnesses of the Opposing Party or a Participant'](#), 12 December 2014, with Annex A (ku nuk bëhet dallimi midis zbatimit të protokollit për kontakte para dhe pas dhënies së dëshmisë); *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-1093, Trial Chamber VII, [Decision Adopting a Protocol on the Handling of Confidential Information during Investigations and Contact Between a Party and Witnesses of the Other Parties](#), 20 July 2015, para. 16, with one Annex (ku Dhoma Gjyqësore VII hodhi poshtë kërkesën për përjashtimin nga protokollit për kontakte të kontakteve pas dhënies së dëshmisë, duke konstatuar se përjashtimi është i palejueshëm dhe se nuk duhet të devijojë nga Protokollit *Ntaganda*); *Prosecutor v. Abdallah Banda Abakaer Nourain et al.*, ICC-02/05-03/09-451, Trial Chamber IV, [Decision on the Protocol on the Handling of Confidential Information and Contact Between a Party and Witnesses of the Opposing Party](#), 18 February 2013, para 17, with one Annex (ku Dhoma Gjyqësore IV konstatoi se protokollit për kontakte nuk devijon nga praktika aktuale dhe se do të vazhdonte gjatë tërë procesit).

³¹ Kërkesa, para. 6

³² *Shih ICC, Chambers Practice Manual, Annex: Protocol on the Handling of Confidential Information during Investigations and Contact Between a Party or Participant and Witnesses of the Opposing Party or of a Participant*, July 2023, pp. 37-47.

³³ *Shih për shembull*, ICTR, *Prosecutor v. Ndindiliyimana et al.*, ICTR-00-56-T, Trial Chamber II, [Decision on Bizimungu's Extremely Urgent Motion to Contact and Meet with Prosecution Witness GAP](#), 26 October 2007, para. 5 (ku Dhoma Gjyqësore II i miratoi mbrojtjes takim pas dhënies së dëshmisë me dëshmitarin në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë); *Prosecutor v. Bizimungu et al.*, ICTR-99-50-T, Trial Chamber II,

19. Gjatë marrjes së vendimit se si të rregullohet ky aspekt, Trupi Gjykses ka marrë parasysh faktin që ky proces po zhvillohet në një atmosferë të ndërhyrjes dhe frikësimit të dëshmitarëve.³⁴ Trupi Gjykses gjithashtu ka parasysh detyrimin e vet për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve dhe për të siguruar integritetin, drejtësinë dhe shpejtësinë e procesit.³⁵

20. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se, pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, rreziqet e lidhura me ndërhyrjen në administrimin e drejtësisë mund të pakësohen në njëfarë mase. Kjo do të thotë se masat e miratuara në lidhje me kontaktet para dhënies së dëshmisë mund të mos jenë të përligjura ose të nevojshme në të njëjtën masë edhe për kontaktet pas dhënies së dëshmisë. Në të njëjtën kohë, rreziku i ndërhyrjes nuk mund të eliminohet tërësisht, edhe pasi dëshmitari të ketë dhënë dëshmi. Gjithashtu është e vërtetë se, edhe pse dëshmitarët e kanë për detyrë qytetare të dëshmojnë në çështje penale,³⁶ ata gjithashtu kanë të drejtë që të mos iu kërkojë vazhdimisht që të japin informacion për një incident në lidhje me të cilin kanë dhënë dëshmi.

21. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja pretendon se Protokolli për Kontakte u pamundëson të akuzuarve që të hetojnë në mënyrën e duhur çështjen kundër tyre

Decision on Jerome Clement Bicamupaka's Motion Requesting Recall of Prosecution Witness GFA; Disclosure of Exculpatory Material; and to Meet with Witness GFA, 21 April 2008, paras 14-16 (ku Dhoma Gjyqësore II i miratoi mbrojtjes takim pas dhënies së dëshmisë me dëshmitarin në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë dhe të Njësisë për Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Viktimave, para se ta thërriste dëshmitarin përsëri); *Prosecutor v. Ngirabatware*, ICTR-99-54-T, Trial Chamber II, *Decision on Defence Motion for Leave to Meet with the Husband of Witness Anae and for Postponement of Her Testimony*, 28 October 2009, paras 22-23 (ku Dhoma Gjyqësore II miratoi intervistën me burrin e dëshmitares së Prokurorisë pas përfundimit të dëshmisë së saj në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë).

³⁴ *Shih, për shembull*, Vendimin mbi Kontaktet, para. 118; F01794, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 15 shtator 2023, para. 33; F01795, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 15 shtator 2023, konfidencial, para. 33 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, F01795/RED); F01861, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 16 tetor 2023, para. 26; F01862, Panel, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 16 tetor 2023, para. 21.

³⁵ Nenet 23(1) dhe 40(2); rregullat 80(1) dhe 116.

³⁶ *Shih, në përgjithësi*, European Court of Human Rights, *Voskuil v. the Netherlands* no. 4752/01, [Judgment](#), 22 November 2007, para. 86; Human Rights Review Panel, *W against EULEX*, no. 2011-07, [Decision](#), 10 April 2013, para. 47.

sepse ata nuk lejohen që të marrin në pyetje dëshmitarët e ZPS-së pa praninë e ZPS-së, përveç nëse këto kontakte videoincizohen dhe i jepen Trupit Gjykses.³⁷ Mbrojtja parashtron se kjo mund të krijojë situatë ku incizimet e intervistave të kryera mund të pranohen si prova *proprio motu* duke i dëmtuar të akuzuarit që kërkuan marrjen në pyetje.³⁸ Këto parashtrime shtrembërojnë frymën e Protokollit për Kontakte. E para, siç është theksuar më parë, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, *dëshmitari* vendos nëse dëshiron që pala thirrëse ose përfaqësues të tjerë të përcaktuar të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje.³⁹ Pëlqimi i dëshmitarit që të merret në pyetje nga pala kundërshtare duhet të merret përmes procedurës së përcaktuar në Protokollin për Kontakte.⁴⁰ E dyta, Protokollin për Kontakte përcakton shprehimisht se “as incizimi i intervistës, as materialet e përdorura gjatë intervistës nuk bëhen pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore”,⁴¹ natyrisht, përveçse kur paraqiten si prova dhe i përmbushin kriteret për pranim.⁴² Kjo është në përputhje me atë se dëshmitarët nuk janë pronë e asnjërës palë⁴³ dhe pranueshmëria e provave që ata paraqesin është objekt i kriterëve të përgjithshme të njëjta.

22. Siç vihet në dukje, Mbrojtja argumenton se Protokollin për Kontakte duhet të zbatohet për “dëshmitarë të zgjedhur me masa mbrojtëse”.⁴⁴ Protokollin për Kontakte nuk parasheh kufizime të tilla.⁴⁵ Protokollin për Kontakte është menduar të zbatohet për të gjithë dëshmitarët, pavarësisht nëse masa të tilla mbrojtëse janë miratuar për

³⁷ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 1.

³⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 1.

³⁹ Vendimi mbi Kontaktet, para. 212 (Protokollin për Kontakte II(b)); Vendimi për Ndryshimin e Vendimit mbi Kontaktet për W04147-ën, para. 26-27; Vendimi në lidhje me Kontaktet me W04290-n, para. 20.

⁴⁰ Vendimi për Ndryshimin e Vendimit mbi Kontaktet për W04147-ën, para. 27; Vendimi në lidhje me Kontaktet me W04290-n, para. 20.

⁴¹ Vendimi mbi Kontaktet, para. 212 (Protokollin për Kontakte II(o)).

⁴² Vendimi mbi Kontaktet, para. 212 (Protokollin për Kontakte II(o)).

⁴³ Vendimi në lidhje me Kontaktet me W04290-n, para. 12; *Shih gjithashtu ICTY, Prosecutor v Mrkšić et al, IT-95-13/1-AR73, Appeals Chamber, [Decision on Defence Interlocutory Appeal on Communication with Potential Witnesses of the Opposite Party](#), 30 July 2003, p. 3.*

⁴⁴ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 23.

⁴⁵ Vendimi mbi Kontaktet, para. 120.

dëshmitarë.⁴⁶ Protokolli për Kontakte siguron që do të merret parasysh çdo shqetësim që dëshmitari mund të ketë për të folur me palën ose pjesëmarrësin kundërshtar dhe që dëshmitari mund të vendosë që të merret në pyetje apo jo nga pala ose pjesëmarrësi kundërshtar.⁴⁷

23. Sa i përket dëmit të shkaktuar për të akuzuarit, Trupi Gjykes kujton se Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se Protokolli për Kontakte është në përputhje me të drejtat e të akuzuarve.⁴⁸ Konkretisht, u konstatua se Protokolli për Kontakte: (i) nuk përmban elemente të drejtpërdrejta ose të tërthorta të detyrimit në kundërshtim me të drejtën e mosinkrimimit të vetvetes; (ii) nuk shkel parimin e barazisë së palëve. as nuk e ngarkon së tepërmi Mbrojtjen, pasi Protokolli për Kontakte është formuluar në mënyrë neutrale dhe vlen për të dy palët; dhe (iii) nuk shkel të drejtat e të akuzuarve për të hetuar çështjen kundër tyre, sepse nuk ekziston e drejta e pakufizuar automatike për të marrë në pyetje dëshmitarët e palës kundërshtare.⁴⁹ Këto kritere vlejné njësoj për kontaktet me dëshmitarë pas marrjes së tyre në pyetje ose pas pranimit të deklaratës së tyre sipas rregullës 153 ose 155.

24. Trupi Gjykes gjithashtu dëshiron të sqarojë se Protokolli për Kontakte, siç është formuluar, gjithashtu përfshin dëshmitarët që palët nuk synojné t'i thërrasin të japin dëshmi drejtpërdrejt, siç janë dëshmitarët dëshmia e të cilëve është ofruar sipas rregullave 153 dhe 155, nëse është e mundshme të kontaktohen.⁵⁰

25. Së fundi, Trupi Gjykes kujton palët dhe pjesëmarrësit se mbesin në fuqi masat mbrojtëse të miratuara për dëshmitarët ndaj publikut. Kjo përfshin dëshmitarët që

⁴⁶ Vendimi i Apelit, para. 45.

⁴⁷ Vendimi mbi Kontaktet, para. 116, 212 (Protokolli për Kontakte II(b)).

⁴⁸ Vendimi i Apelit, para. 60, 70, 86.

⁴⁹ Vendimi i Apelit, para. 57, 77, 79, 81.

⁵⁰ *Shih* Vendimin mbi Kontaktet, para. 212 (Protokolli për Kontakte II(a)) ku thuhet "Përveç sipas kushteve të përcaktuara këtu, palët dhe pjesëmarrësit nuk kontaktojnë apo intervistojné dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësit tjetër para dhënies së dëshmisë, në qoftë se palës ose pjesëmarrësit kundërshtar i është njoftuar synimi për ta thirrur dëshmitarin për të dhënë dëshmi ose për t'u mbështetur në deklaratën e tij."

merren në pyetje, ose dëshmitarët dëshmia e të cilëve i paraqitet personave ose dëshmitarëve që merren në pyetje.

V. VENDIM

26. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **URDHËRON** që Protokollin për Kontakte të zbatohet gjatë gjithë këtij procesi, përfshirë edhe kur një palë ose pjesëmarrës kundërshtar dëshiron të marrë në pyetje dëshmitarin e palës ose pjesëmarrësin tjetër që tashmë ka dhënë dëshmi në këtë gjykim, apo deklarata e mëparshme e të cilit është pranuar sipas rregullës 153 ose 155;
- c) **URDHËRON** palët dhe pjesëmarrësit që të respektojnë Protokollin për Kontakte në lidhje me të gjitha kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare; dhe
- d) **KUJTON** palët dhe pjesëmarrësit se masat mbrojtëse mbesin në fuqi dhe zbatohen, përfshirë në lidhje me dëshmitarët që janë marrë në pyetje, ose dëshmitarët dëshmitë e të cilëve u paraqiten personave ose dëshmitarëve që merren në pyetje.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 27 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë.